



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:043961  
Datë: 20.02.2024  
Numri i dokumentit: 05390099

**Ac.nr.1404/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi, dhe Enes Mehmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.Y., nga fshati B., Komuna Shtërpcë, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson N.B., avokat në Ferizaj, kundër të paditurës Komuna e Shtërpcës - Drejtoria për Arsim, lidhur me kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga e paditura, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë, C.nr.26/2020 të datës 11.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Shtërpcës-Drejtoria për Arsim, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë, C.nr.26/2020, i datës 11.12.2020, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.26/2020 të datës 11.12.2020, ka vendosur si në vijim: “I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh.Y. nga fshati B. Komuna Shtërpcë, II. DETYROHET e paditura Komuna e Shtërpcës-Drejtoria për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim në punë paditësit Sh.Y., për periudhën nga data 18.04.2017 e deri me datë 31.03.2020 për 555 ditë pune në vlerë prej dy euro, për një ditë pune t’ia paguaj shumën prej 1.110.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë (10.04.2020), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II. Pjesërisht aprovohet kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe obligohet e paditura që paditësit t’ia kompensoj të njëjtat në shumë prej 135 euro në afat prej

7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbartimit me dhunë, nga shuma e kërkuar prej 270 euro, ndërsa shuma prej 135 euro refuzohet si e pa bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura përmes të autorizuarit të saj, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozim Gjykatës së Apelit, aktgjykim e atakuar ta prish dhe lëndën ta kthen në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar autorizuari i paditësit me propozim që të refuzohet ankesa e të paditurës si e pa bazuar ndërsa aktgjykimin e atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi Sh.Y., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.B., avokat në Ferizaj, me datë 10.04.2020, në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Shtërpcës-Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e ushqimit gjatë punës. Me parashtresën e datës 09.11.2020, e ka bërë precizimin e kërkesëpadiës, ashtu që ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Shtërpcës -Drejtoria për Arsim, që paditësit në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë se tij në punë për 555 ditë t'ia paguaj shumën prej 1,110.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 03.04.2020 e deri në pagesën definitive si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore në emër të takës gjyqësore për padi prej 31 euro, për përpilim të padis shumën prej 104 euro dhe pjesëmarrjes në seancës gjyqësore në shumë prej 135 euro e të gjitha këto në shumë prej 270 euro në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë jashtë seancës ka nxjerrë aktgjykim për shkak të mosbindjes, C.nr.26/2020 të datës 11.12.2020, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më saktësisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se të paditurës me datë 16.11.2020, i është dorëzuar padia me prova për të dhënë përgjigje në padi, e cila vërtetohet në bazë të fletëdergimit për dorëzim personal që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa e paditura nuk ka paraqitur përgjigje në padi, dhe në këtë rast gjykata ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet nga neni 150 të LPK-së për marrjen e aktgjykimin për shkak të mosbindjes, pasi që e paditura nuk ka paraqitur përgjigje në padi dhe nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe bazueshmëria e kërkesëpadiës rrjedh nga faktet dhe provat e bashkangjitura padisë, dhe faktet në të cilat mbështet kërkesa nuk bien ndesh me provat e paraqitura nga pala paditëse dhe as nuk bëhet fjalë për kërkesa që palët nuk mund të disponojnë, në përputhje me nenin 3 të LPK-së. Duke marrë parasysh faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia, vërtetimin Nr.02/56/2020, të datës 05.11.2020, të lëshuar nga Shkolla e Mesme e Ulët "Razim Cokli", Brod- Shtërpcë, gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadiës së paditësit i është referuar nenit 35 par.7 të Kontratës

Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18 Prill 2018, ku parashihet e drejta e punëtorëve në kompensim monetar prej 2 euro për çdo ditë pune në emër të shpenzimeve për ushqim. Ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e ka bazuar në nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plot me arsyet e dhëna në aktgjykim, dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për marrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes siç parashihet me nenin 150 të LPK-së, pasi që e paditura nuk ka paraqitur përgjigje në padi në afatin e paraparë ligjor, ashtu siç ka qenë e obliguar me aktvendimin C.nr.26/2020, të datës 06.07.2020, edhe pse në bazë të fletëdërgesës për dorëzim personal rezulton së të paditurës padia me prova i është dorëzuar me datë 16.11.2020. Sa i përket pretendimit të së paditurës së padia nuk i është dorëzuar personave të autorizuar në shkrimore – zyrën e pranimit në mënyrën e paraparë, Gjykata e Apelit, vlerëson së në rastin konkret dorëzimi i padisë për përgjigje është bërë në mënyrë të rregullt ashtu siç përcaktohet me nenin 104 par.1 të LPK-së, sipas së cilës *“Dërgimi organeve shtetërore dhe personave juridik u bëhet duke iu dorëzuar shkresat personit të autorizuar për pranimin e tyre apo të punësuarit që gjendet në zyrën, gjegjësisht në lokalin e punës”*. Siç rezulton kjo dispozitë e lejon mundësin që përveç personave të autorizuar për pranimin e shkresave, dorëzimi mund t’i bëhet edhe të punësuarve tjerë që gjenden në lokalin e punës. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, ku në bazë të vërtetimit të datës 05.11.2020, të lëshuar nga Shkolla e Mesme e Ulët “Razim Cokli”, Brod-Shterpçë, është vërtetuar së paditësi është në marrëdhënie pune në këtë shkollë, dhe për periudhën nga data 18.04.2017 e deri me datë 31.03.2020, i ka 555 ditë pune në këtë shkollë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, përcaktohet se: ”Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4

përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”. Me nënshkrimin e Kontratës Kolektive nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe përfaqësuesit të paditësve të sektorit të arsimit, Ministria ka marrë obligime në emër dhe llogari të të paditurës, ndërsa obligimi për kompensim bie mbi të paditurën pasi është punëdhënës i paditësit. Koordinimi ndërmjet nivelit lokal (Komunës) dhe nivelit qendror (Qeverisë-Ministrisë) nuk afekton në të drejtën e paditësit.

Gjykata e Apelit vlerëson se kërkesëpadia e paditësit lidhur me kompensimin e ushqimit gjen mbështetje në nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila është nënshkruar nga MASHT-it dhe SBASHK-ku, dhe ka hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit datë 18.04.2017, është paraparë së “*Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë . Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2(dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore*”. Duke pasur parasysh se paditësi për periudhën 18.04.2017 e deri me datë 31.03.2020, ka 555 ditë të pranisë në punë, në këtë rast Gjykata e Apelit, pajtohet me vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë që paditësit t’i njihet kompensimi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, pasi që gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në përputhje me dispozitën e sipërcituar lidhur me të drejtën e paditësit për kompensimin e ushqimit, e që aktgjykimi është marrë në mënyrë të ligjshëm dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë pasi që janë plotësuar kushtet e parapara ligjore për marrjen e të njëjtit sipas nenit 150 të LPK-së.

Vendimi lidhur me kamatën është marrë konform nenit 382 par.2 të LMD-së dhe Mendimin juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 02.12.2020. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 449 dhe 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), e lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.1404/2021, datë 20.02.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,  
Hysni Bardheci